



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
GRUPI PARLAMENTAR DEMOKRACI DHE INTEGRIM

Nr. 2697 Prot.

Tiranë, më 03.07. 2024

**Lënda:** Propozim për miratimin e deklaratës “Për forcimin e bashkëpunimit me Republikën e Greqisë dhe heqjen e ligjit të luftës”.

**Lindita NIKOLLA  
KRYETAR  
KUVENDI I SHQIPËRISË**

E nderuar znj. Nikolla, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,

Bazuar në nenet 55, 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit, grupi parlamentar “Demokraci dhe Integrim” propozon shqyrtimin dhe miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të deklaratës “Për forcimin e bashkëpunimit me Republikën e Greqisë dhe heqjen e ligjit të luftës” sipas dokumentit bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Grupi parlamentar  
“Demokraci dhe Integrim”

  
Mesila DODA  
Kryetar

## DEKLARATE

Kuvendi i Shqipërisë, duke vlerësuar rëndësinë e madhe dhe nivelin shumë të mirë të marrëdhënieve dypalëshe strategjike me Greqinë, si dhe vullnetin e dyanshëm për t'i përmirësuar e thelluar ato në të mirë të dy vendeve dhe popujve tanë, si dhe kontributin për forcimin e paqes, sigurisë dhe bashkëpunimit në rajonin tonë.

Duke mbajtur parasysh se dy vendet tonë janë anëtare të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe në këtë kuadër bashkëpunojnë pa rezerva për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes tonë të përbashkët.

Duke mbajtur shënimkontributet e përbashkëta të vendeve tona në organizatat e bashkëpunimit për paqen, sigurinë dhe të drejtat e njeriut, në rradhë të parë OSBE dhe KiE.

Duke vlerësuar kontributin e Greqisë për ecjen përpara të proceseve integruese në Bashkimin Evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor, dhe bashkëpunimin në organizatat rajonale përkatëse.

Duke mbajtur parasysh se midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë është nënshkruar "Traktati i Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë dhe Sigurisë."

Duke mbajtur shënimse marrëdhëniet mes vendeve tona kanë ecuri pozitive dhe se të dy vendet, në frymën e mirëkuptimit dhe në të mirë të dy popujve tanë, kanë bashkëpunuar për të zgjidhur çështjet hapura mes vendeve tona.

Vëren se, ndryshe nga fryma e " Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë dhe Sigurisë ", si dhe nga vullneti politik i dyanshëm i shprehur në mënyrë të përsëritur, Ligji i Luftës Nr.2636/40, mbetet ende në fuqi dhe vijon të prodhojë disa nga efektet negative që lindin kur shtetet janë në gjendje lufte;

Me synimin dhe dëshirën për të zgjidhur edhe këtë çështje të trashëguar nga një e kaluar që nuk mund të kthehet,

### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

- I bindur në vullnetin e mirë të Parlamentit të Republikës së Greqisë për të dhënë shtysë pozitive marrëdhënieve dypalëshe me Shqipërinë, duke bërë përpjekje konstruktive për të zgjidhur çdo çështje të hapur,

- Fton Parlamentin e Republikës së Greqisë të mbështesin përpjekjet e qeverisë së tyre për jetësimin e vullnetit politik të shprehur më shumë se një herë nga Ministrat e Jashtëm të Republikës së Greqisë për abrogimin e Ligjit të Luftës Nr.2636/40 me Shqipërinë, dhe në këtë frymë pozitive të marrin në konsideratë e të miratojnë çdo instrument ligjor që do ti shërbente korrigjimit të kësaj situate që nuk përputhet me realitetet e marrëdhënieve dypalëshe Shqipëri-Greqi.
- Në përputhje me angazhimin ndërparlamentar të parashikuar në Traktatin e miqësisë, bashkëpunimit reciprok, sigurisë mes dy vendeve, ne bëjmë thirrje të krijohet një grup pune mes dy Parlamenteve që të kontribuojë zyrtarisht në këtë drejtim, apo në adresimin e çdo problemi të ngjashëm në marrëdhëniet mes dy vendeve tona sipas parimeve të njohura të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjithashtu,

### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

- I kërkon Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të bëjë çdo përpjekje me qeverinë e Greqisë për abrogimin e Ligjit Nr. 2636/40, dhe pasojat juridike që burojnë nga ky ligj.
- I kërkon Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në vijim të kontributeve të konfirmuara të politikës sonë të jashtme për fqinjësi të mirë, për paqe dhe për siguri, të mbajë të informuar rregullisht Kuvendin e Shqipërisë dhe partnerët tanë euroatlantikë Nato dhe BE për përpjekjet sistematike të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me qeverinë e Republikës së Greqisë, për zgjidhjen e kësaj çështje të bartur nga e kaluara.

## RELACION

### SHOQËRUES I DEKLARATËS SË KUVENDIT “PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT ME REPUBLIKËN E GREQISË DHE HEQJEN E LIGJIT TË LUFTËS”

Kuvendi i Shqipërisë, ushtrues i sovranitetit të qytetarëve, vlerëson thellësisht rëndësinë e madhe që kanë marrëdhëniet e bashkëpunimit me Greqinë në të gjitha fushat dhe nevojën e vazhdueshme të përmirësimit të tyre si shtete, si kombe, si shoqëri.

Qysh në Preambulën e Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë dhe Sigurisë”, firmosur në 31 mars 1996, hyrë në fuqi në 1998, theksohet se këto marrëdhënie janë themeluar mbi “...traditat e miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës që popujt e tyre i kanë ofruar historikisht njëri-tjetrit, si dhe konvergencën e interesave të tyre thelbësore drejt integritetit europian” .

Ky traktat, siç nënvizohet edhe në Preambul, ka qenë për rreth 30 vite, një bazë e fuqishme për avancimin e marrëdhënieve të miqësisë me themele historike dhe për bashkëpunimin në plan dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar.

Por, me keqardhje vërehet se:

- ndryshe nga fryma dhe gërma e Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së Mirë dhe Sigurisë, në dhunim të hapur të shumë neneve të tij;
- Megjithë vullnetin politik të shprehur publikisht në mënyrë të përsëritur nga përfaqësues të lartë të Greqisë, zgjidhjet e negociuara për ta shfuqizuar atë dhe adresuar pasojat ligjore të tij;
- Ligji i Luftës Nr. 2636/40 mbetet ende në fuqi dhe vijon të prodhojë disa nga efektet negative që lindin kur shtetet janë në gjendje lufte

Më 28 tetor 1940, Mbretëria e Greqisë shpalli Ligjin e luftës me dekretin 2636, të pasuara nga një sërë ligjesh të tjera pjesë e sistemit juridik grek.

Bazuar ne Dekretin 10.11.1940 "Rreth percaktimit si shtete armike, sipas ligjit 2636/40, te Italisë dhe Shqiperisë, shkruhet:

*"Shtetet e përcaktuara si armike në kuptimin e 2636/40, janë Italia së bashku me tokat perandorake dhe kolonitë e saj, duke përfshirë edhe Shqipërinë"*

Dispozitat e këtyre ligjeve vihen ne zbatim per shtetet e mësipërme që nga 28 tetori 1940

Ligji në fjalë padyshim është një absurd!!

Në vitin 1999, ministria e jashtme greke pohon me shkresën zyrtare për ministrinë e jashtme të Republikës së Shqipërisë F.237/269, dt.28/06/1999 se ligji 2636/40 është në fuqi.

Më 02/01/2018 Ministri i jashtëm i Greqisë Kotzias shprehej se Ligji i Luftës “është një budallallëk historik, i cili duhet të mbarojë, , i cili vazhdon...”*Nuk duhet të ketë as edhe një dyshim formal se te dy vendet mund të jenë në gjendje lufte. Kjo është çështja kryesore që duhet zgjidhur pozitivisht”.*

Më 20/10/2020 Ministri i Jashtëm Dendias gjatë vizitës në Tiranë deklaroi: “*Sa i përket ligjit të luftës... Kjo gjë është një anakronizëm, jam i sigurtë se edhe këtë do ta zgjidhim së bashku. Dhe është gëzim i madh për mua që kam mundësinë ta them këtë gjë këtu, nga Tirana, me urdhër të Kryeministrit Mitsotakis”.*

Ne viziten e tij në Tiranë, më 22/10/2022 ministri i jashtëm Dendias deklaroi se do të nisnin procedurat për abrogimin e ligjit, i cili daton që nga viti 1940. Sipas ministrit të Jashtëm grek, *dy vendet duhet të bashkëpunojnë ndërmjet tyre, që pikat historike për abrogimin e tij, të përmbillen sa më shpejt të jete e mundur.*

*Ky ligj ushtron implikime të rëndësishme në:*

- kufizimin e të drejtave themelore të shtetasve shqiptarë;
- planin e rivendikimeve territoriale ndaj vendit tonë. Ky është akt që mban gjallë irredentizmin e qarqeve të caktuara ekstremiste greke.

Kufizimet e të drejtave themelore të individëve, të trashëgimtarëve të tyre janë të qarta.

Ndërkohë për implikimet që lidhen me pretendime territoriale, mjafton të lexosh edhe media greke që kanë referime në lidhje me këto rivendikime.

*Përse kjo deklaratë parlamentare?*

**Së pari**, në planin e marrëdhënieve dypalëshe, synohet ta sjellim dialogun mes dy vendeve tona në një terren konkret, në kërkesa që kanë vlerë reale, të pashterrueshme nga koha, ndonëse me prejardhje nga Lufta e dytë botërore, dhe për ta nxjerrë kështu dialogun nga çështje të sforcuara me natyrë propagandistike të ditëve tona.

**Së dyti**, për të përfshirë në një çështje kaq të rëndësishme Parlamentin e vendit, pas përfshirjes së qeverisë apo diplomacisë në nivele të ndryshme. Nëse qeveria për një arsye apo një

tjetër pamundësohet, parlamenti vendi i përfaqësuesve të popujve që duan paqe me fqinjët, bashkëpunim të mirë me to, *mund të avancojë në kuadër të diplomacisë parlamentare*, por jo vetëm.

*Vlen të theksohet, se asnjë forcë politike në Shqipëri, përtej ngjyrymeve partiake, nuk ka rivendikime territoriale ndaj asnjë vendi fqinj, pra edhe ndaj Greqisë.*

Edhe kërkesat që paraqiten, kanë bazament juridik, jo territorial, dhe as historik. Të avancuara me rrugë demokratike ato janë tërësisht legjitime.

Kjo është arsyeja përse mendojmë se deklarata do të gjejë mbështetje konsensuale në të dy krahët e politikës, çfarë do të rrisë presionin apo ndjeshmërinë tek qeveria e Shqipërisë, tek ajo greke, apo dhe parlamenti i vendit fqinjë.

**Së treti**, përfshirja e parlamentit, nëpërmjet diplomacisë parlamentare, është nxitje në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, për ti dhënë fund sa më shpejt një situatë absurde, që vazhdon prej 84 vitesh, me abrogimin e Ligjit Nr. 2636/40 dhe pasojave juridike që burojnë nga ky ligj.

***Në lidhje me mjetin parlamentar të zgjedhur.***

Deklarata është një instrument i qëndrimeve politike nga ana e parlamentit, i cili kalon me konsensus apo me votim, duke u shprehur për një çështje me interes të lartë kombëtar.

Nuk është rezolutë, sepse nuk i drejtohet vetëm insitucioneve të brendshme, me kërkesën për të raportuar për zhvillimet në lidhje me çështjen e ligjit të luftës, por dhe atyre të vendit fqinj, në formën ***e një ftese për bashkëpunim***, që mund të nënkuptojë dhe themelimin e një grupi ndërparlamentar mes dy vendeve, për të adresuar problemin e abrogimit të ligjit të luftës Nr. 2636/40 dhe pasojave juridike që burojnë nga ky ligj, apo çështje të ngjashme. *Në Traktatin e Miqësisë, në paragrafin 3 të nenit 17, pohohet rëndësia e kontakteve midis parlamenteve dhe grupeve ndërparlamentare.*

Kjo thirrje apo ftesë bëhet me synimin dhe dëshirën për të kontribuar dhe ne si të zgjedhur të popullit, në mbarimin e këtij *nonsensi historik, që të mos ketë as edhe një dyshim formal se të dy vendet janë në gjendje lufte.*

**Së katërti**, deklarata në fjalë lidhet me një çështje, *për të cilën pala greke ka ofruar pranimin e saj se problemi ekziston*, madje për këtë problem ka ofruar dhe zgjidhje të ndryshme, nga dy ministra të jashtëm të paktën - zoti Niko Kotzias në 2018, dhe Nikos Dendias në 2022.

***Nuk është qëllimi i deklaratës në fjalë për të identifikuar zgjidhje, por për ti nxitur ato zgjidhje nëpërmjet diplomacisë, të cilat mund të asistohen apo lehtësohen në miratim dhe nga parlamentet respektive.***

Më në fund, kjo deklaratë konfirmon nevojën dhe zgjidhjen e këtij problemi në frymën e miqësisë dhe mirkuptimit në të mirë të popujve tanë.

**Deklarata është dhe dëshmi e politikës sonë paqësore por të vendosur, për të gjetur një zgjidhje pas 84 vitesh, në lidhje me një absurd juridik të mbështetur mbi një absurd historik.**

Në 28 Tetor 1940 Shqipëria nuk ka qenë shtet sovran që të sulmonte fqinjin e vet, e si pasojë Greqia ta shpallte shtet armik dhe të vendoste gjendjen e luftës me vendin tonë.

Shqipëria ishte shtet i pushtuar, pa sovranitet, pa subjektivitet ndërkombëtar, pa liri veprimi, dhe këtë fakt në akte të tjera e ka pranuar dhe vetë Greqia.

Inercia historike në sjelljen e qeverive greke, paaftësia e qeverisjes komuniste për të imponuar një zgjidhje, etj..., kanë sjellë si pasojë mbajtjen në këmbë të një ligji kaq absurd.

Për të gjithë këto arsye, ne besojmë se deklarata do të gjejë mbështetjen e të gjithë parlamentit konsensualisht.

Shqiptaria.com